

RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR

**MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERDORURA NE FUSHATEN
ZGJEDHORE, PER ZGJEDHJEN E QEVERISJES VENDORE
QERSHOR 2015,
NGA SUBJEKTI
PARTIA FORCA RINIA**

Drejtuar:

KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE
Bulevardi ``Deshmoret e Kombit``
``Pallati i Kongreseve``, Tirane

Nga:

Stoli LAZE
Eksperte Kontabel e Regjistruar
Nr Licence 36 dt. 10.02.2000
Blv ``Gjergj Fishta``,
Nd. 30, P. 18, Ap.8 PO BOX 1001
prane ``Ish Ekspozites``, Tirane

**PERIUDHA E AUDITUAR: MAJ-QERSHOR 2015
KOHEZGJATJA E AUDITIMIT: 29SHTATOR - 27 TETOR 2015**

Stoli Laze - Eksperte Kontabël e Regjistruar

Cel. 069 21 73 995 Cel. 069 23 38 011

RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR MBI ANGAZHIMET E
AUDITIMIT PER QELLIME TE VECANTA.

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA
NE FUSHATEN ZGJEDHORE ,PER ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES
VENDORE MAJ-QERSHOR 2015,
NGA SUBJEKTI
PARTIA FORCA RINIA

Drejtuar: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

Bulevardi "Deshmoret e Kombit"

"Pallati i Kongreseve",Tirane

Ne kemi audituar pasqyrat dhe dokumentet pasqyruese te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore, per zgjedhjet vendore per Bashkite ne 21 Qershor 2015 te kryera nga PARTIA FORCA RINIA, e krijuar vendim Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane Nr 3870 date 12.04.2013 me Nr.11484 Akti , ndryshuar me Vendimin Nr.8386 date 27.12.2014 me Nr.12013 Akti per ndryshim emri. Auditimi perfshin periudhen 21 Maj deri me 21 Qershor 2015 si dhe te periudhave paraardhese e pasardhese ne te cilat jane kryer veprime financiare ne dobi te fushates zgjedhore .

Pasqyrat dhe dokumentat janë përgjegjësi e drejtimit të "PARTIA FORCA RINIA".

Paqyrat dhe librat permbledhes te aktivitetit financiar jane pergatitur nga drejtimi i PARTIA FORCA RINIA bazuar ne librin e llogarive dhe te rregjistrit te posaçem, miratuar si model me vendim te KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjithë transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore, që kanë dhënë bazën për auditimin. Politika e ndjekur nga ana e drejtimit eshte te pergatise pasqyrat mbi bazen e fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te realizuara gjate periudhes se fushates zgjedhore . Mbi kete baze , fondet e perfituara njihen kur fitohen ne leke ose ne material dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer.

Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit në referencë të vecantë me SNA 800 "Konsiderata të vecanta-Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike". Këto standarte kërkojnë që ne të veprojme në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikojme dhe të kryejme auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyra financiare e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të mos përmbajë anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyra. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse, qoftë për shkak të mashtrimit, ashtu dhe të gabimit. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të drejtimit që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në aktivitetin financiar, vlerësimin e parimeve të përdorura të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi.

Ne çmojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas mendimit tonë, ne mungese të financimeve nga fondet publike apo financimeve nga individë apo fonde private, pasqyrimi dhe përdorimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, ne Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore ne date 21 Qershor 2015 nga PARTIA FORCA RINIA janë kryer ne respekt te ligjit dhe ne perputhje me Kodin Zgjedhor.

Tirane me 27.10.2015

Eksperte Kontabel e Regjistruar



RAPORT I AUDITIT TE PAVARUR MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PER QELLIME TE VECANTA.

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA
NE FUSHATEN ZGJEDHORE ,PER ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES
VENDORE MAJ-QERSHOR 2015,
NGA SUBJEKTI
PARTIA FORCA RINIA

ANEKSI I PARE

INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Fondet publike dhe jo publike te perfituara dhe te shpenzuara nga subjekti per fushaten zgjedhore per *Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore ne date 21 Qershor 2015.*

2. SUBJEKTI I AUDITIMIT

Subjekti **PARTIA FORCA RINIA**, per *Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore ne date 21 Qershor 2015.*

3. INFORMACION MBI AUDITIMIN

- a) Auditimi eshte mbeshtetur ne dokumentacionin financiar te kesaj periudhe per periudhen (Maj-Qershor 2015).
- b) Auditimi eshte mbeshtetur ne kerkesat e LIGJIT Nr.10019, datë 29.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË" i ndryshuar.

4. PERIUDHA E AUDITIMIT

Tetor 2015

5. PERSONAT E KONTAKTUAR PER AUDITIMIN

Emri Mbiemri DRITAN BROKA

Pozicioni/Titulli Kryetar PARTIA FORCA RINIA

ANEKSI I DYTE

ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR

1. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet publike

Ne LIGJIN Nr.10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, Neni 87 "Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike për subjektet zgjedhore" pika 2 shpreh " Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme"

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qene perfitues i fondeve publike per Zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore ne date 21 Qershor 2015 ne masen 0 leke. U kontrollua llogaria nuk ka leke te arketuar ne llogarine bankare.

2. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike

Ne LIGJIN Nr.10019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, Neni 89 "Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike" Neni 90 "Regjistrimi i fondeve jopublike" *konstatohet se:*

Neni 89 pika 1 shpreh:

Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas kjo sipas deklarimit te perfaqesuesit si dhe te regjistrit te dhurimeve apo prej historikut te llogarise bankare.

Neni 89 pika 2 shpreh:

Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefë në sende ose shërbime.

Konstatohet:

Subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas.

Neni 89 pika 3 shpreh:

Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- a) ka përfitur fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;
- b) ushtron veprimtari në fushën e medias;
- c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Konstatohet:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk ka qene perfitues i asnje fondi per qellime te fushates zgjedhore nga persona fizike apo juridike vendas i cili ndodhet ne kushtet e mesiperme.

Neni 90 pika 1 shpreh:

Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në

çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike.

Konstatoj:

Nga verifikimet e kryera rezulton se ne përputhje me kete nen, subjekti zgjedhor ka mbajtur regjister te posaçem sipas modelit te miratuar nga KQZ-ja.

Neni 90 pika 2 shpreh:

Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaror numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Konstatoj:

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti nuk është zoterues i një llogarie të vecante për fonde për qëllim të fushatës zgjedhore.

Neni 90 pika 3 shpreh:

Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 87 të këtij Kodi. Çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

Konstatoj:

- Subjekti nuk ka përfituar fonde publike dhe për rrjedhojë shpenzimet e kryera nuk mund të nenshtrohen krahasimit në përputhje me pikën 3 të nenit 90.
- Shpenzimet e kryera janë në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Tirane me 27.10.2015

Eksperte Kontabël e Regjistruar



